



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

*E-mail: [rmuca@kish.org.al](mailto:rmuca@kish.org.al); Web-site: [www.kish.org.al](http://www.kish.org.al)*

Nr. 739/9 Prot.

Tiranë, më31/12/2016

**V E N D I M**  
**Nr. 186, Datë 31. 12. 2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**“Menaxhimi i Parqeve Kombëtare”**

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 739/2, datë 30.09.2016 realizoi auditimin e performancës me temë **“Menaxhimi i Parqeve Kombëtare”**. Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Mjedisit; Agjencinë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në 12 qarqet e vendit ( Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë). Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 739/6, datë 30.11.2016 u dërgua projekt-raporti i auditimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me detyrimin e shpërndarjes në të gjitha institucionet e sipërcituara. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh të dhënat sipas pyetësorëve dhe shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" :

**K O N K L U D O V A:**

“.....në Konventën e Aarhus- it thekson nevojën për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet mjedisore dhe qasjen në informata mjedisore të mbajtura nga autoritetet publike.....”

***Kofi A. Annan,***  
***Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>***

<sup>1</sup> <http://www.unece.org>.

Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotike dhe jo biotike që nxisin dhe zhvillojnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin fizik, natyror të ajrit, tokës, ujërave etj. Faktorët natyrorë dhe shoqërorë të mjedisit ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njeriut. Ata janë një kusht thelbësor për të përcaktuar zhvillimin e tyre fizik, mendor, intelektual, psikologjik dhe vete mënyrës së jetesës së tyre.

Jo të gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëloj ndaj mjedisit. Disa zhvillojnë veprimtari mbrojtëse ndërsa të tjerë e shfrytëzojnë në mënyrat me barbare atë. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale. Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë e atë. Shoqëria si në vendin tonë ashtu edhe në mbarë botën po përballet me problem të mëdha që lidhen me mjedisin si: ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore etj. Ndotja e mjedisit, është futja e drejtpërdrejte ose e tërthorte e lendeve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmave të cilat e ndryshojnë cilësinë e mjedisit e të jetës.

Mbrojtja e biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër në politikën e një vendi kanë rol të rëndësishëm dhe me interes të përgjithshëm publik si në zhvillimin ekonomik dhe në të ardhmen e brezave.

Kur trashëgimia natyrore cilësohet si vlerë unike në shkallë ndërkombëtare, vlerat e saj cilësohen "Trashëgimi Botëror". Si e tillë, së bashku me trashëgiminë e veçantë kulturore (materiale e shpirtërore) të popujve, radhitet në Listën e Trashëgimisë Botërore, që mbrohen nga Konventa e Trashëgimisë Botërore. Midis 981 sitet (qershor 2013) të kësaj liste, me plot dinjitet e vlera unike, qëndrojnë edhe sitet tona: Liqeni i Ohrit, Butrinti, Gjirokastra, Berati (Shqipëri), Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejës, Kisha e Levishës Prishtinë, Manastiri i Graçanicës (Kosovë) dhe qyteti i Ohrit nga bota shqiptare jashtë kufijve tanë politikë.

Trashëgimia është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo përbën vlerë të mjedisit natyror dhe, si e tillë, është natyrore, por edhe vlerë materiale e shpirtërore e shoqërisë dhe, si e tillë, është kulturore. Vlerat e saj mund të kenë rëndësi kombëtare dhe cilësohen si "Trashëgimi Natyrore Kombëtare". Ato mbrohen nga ligjet kombëtare. Çdo vend i kulturuar e cilëson dhe e trajton si të shenjtë trashëgiminë natyrore dhe kulturore, sepse me to është i lidhur identiteti kombëtar. Vazhdimisht trashëgimia natyrore kombëtare është kërcënuar dhe kërcënohet nga veprimtaria njerëzore mbi mjedisin dhe vlerat e tij. Kjo e ka bërë të domosdoshme gjetjen dhe aplikimin e mënyrave e rrugëve për mbrojtjen e saj. Duke u mbështetur në politikën e strategjitë e përcaktuara nga UNESCO për mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore Botërore, çdo shtet harton politikën e strategjitë për vlerësimin, mbrojtjen e menaxhimin e trashëgimisë së vetë kombëtare. Për këtë qëllim, hapësirave me vlera të veçanta iu jepet statusi "zonë e mbrojtur", për të evidentuar dhe mbrojtur këto vlera të trashëguara dhe për t'ua përcjellë ato brezave të ardhshëm.

Mbrojtja e tyre, si një proces tepër kompleks, kërkon njohjen dhe aplikimin e koncepteve të reja ekologjike, sociale, ekonomike, politike; pjesëmarrjen si partnerë të shumë aktorëve: organe shtetërore, komuniteti i banorëve të zonës me rol të veçantë, OJF-ve; kërkon ndihmesën e të gjithë qytetarëve. Ajo realizohet nëpërmjet: mbështetjes ligjore dhe institucionale, formulimit të strategjive dhe politikave të përshtatshme; përgatitjes dhe zbatimit të programeve të studiuara. Monumentet e natyrës janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kombëtare, të papërsëritshme dhe të pakthyeshme për natyrën dhe shoqërinë tonë të cilat janë:

- Burim i pazëvendësueshëm informacioni për shumë shkencë;
- Burim për kërkime shkencore;

- Burim kulture për njerëz të profesioneve dhe të moshave të ndryshme;
- Burim të ardhurash;
- Mjete të pazëvendësueshme didaktike, ku nxënësit e studentët në këto laboratorë të vërteta natyrore marrin e konkretizojnë njohuritë shkencore;

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes është vitale për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Pjesëmarrja në vendimmarrje krijon një urë komunikimi në mes të autoriteteve publike në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër, në çështjet që përfshijnë interesin e përgjithshëm dhe publik. Përmes pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes, qytetarëve ju sigurohet e drejta e pjesëmarrjes, të kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve dhe veprimtarive të organeve lokale dhe qendrore në çështjet që ndikojnë në jetën e tyre në kuptimin publik, ekonomik, social, shëndetësor dhe mjedisor. Një interaksion i tillë mundëson shkëmbimin e ideve dhe komenteve që janë relevante për autoritetet publike në procesin e dizajnit të programeve, dokumenteve dhe planeve të natyrës publike.<sup>2</sup>

Ndërmjet këtij auditimi dëshirojmë të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për zonat e mbrojtura e në veçanti për parqet natyrore kombëtare, e për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit; administrimit të integruar në strategjitë, politikat, planet, programet dhe veprimtaritë në nivel kombëtar, rajonal e vendor; konsiderimit të popullsisë të zonave të mbrojtura si faktor të rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të parqeve kombëtare natyrore, duke i përfshirë ata në vendimmarrje dhe hartimin e planeve të administrimit të integruar të zonave të mbrojtura. Të gjitha këto bëjnë të mundur që, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos të turizmit, të rriten ndjeshëm të ardhurat e banorëve vendas, të përmirësohet cilësia e jetës së tyre dhe ruajtjen e tyre si trashëgimi për brezat.

Auditimi i performancës synon të promovojë **përmirësime në performancën e shërbimeve publike**. Filozofia e re drejtuese në KLSH e ka vënë auditimin e performancës në qendër të vëmendjes si motor të zhvillimit institucional. Misioni i KLSH-së në Planin Strategjik 2013-2017 përkufizohet: **Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike**, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Rezultatet e disa politikave publike tregojnë një hendek mes qëllimeve të tyre e skemave në njërin anë, dhe kompleksit e natyrës gjithnjë në ndryshim të problemeve shoqërore dhe ekonomike në anën tjetër. Ato kërkojnë një tip të ri përgjegjësie, në të cilën auditimi i sektorit publik duhet të luajë rolin e tij duke marrë një qasje dinamike më tepër se një qasje statike, deklaruese pas punës së bërë.

Auditimet e performancës në KLSH udhëhiqen nga Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, Manuali i tij dhe Indikatorët e tyre, të cilat konsiderohen si dokumente dinamike, që përditësohen me progresin praktik. Ato nuk janë thjesht dokumente normative apo teknike, apo një referencë e shpejtë, por përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh me implikime praktike, që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Madje këtu vlen të theksohet se Manuali dhe Indikatorët e Auditimit të

<sup>2</sup> Konventa e Aarhus

Performancës mbas një konsultimi të gjerë institucional e më shumë kanë marrë tashmë formën ligjore nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. B L duke u botuar edhe si libra.

“Auditimi i performancës” ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe përfshin:

a) auditimin e ekonomicitetit, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij.

b) auditimin e efijencës, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

c) auditimin e efektivitetit, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikatat e subjektit të audituar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar thellimin e realizimit të misionit të tij, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës ai nxjerr në pah ekonomicitetin, efijencën dhe efektivitetin në mënyrë direkte ose indirekte, ndihmon entet shtetërore për të vlerësuar veten e matur rezultatet e tyre dhe për të përcaktuar (gjetur) mundësi të tjera për rritjen e rezultateve me të njëjtën kosto.

KLSH këshillon dhe ndihmon drejtuesit dhe personelin e këtyre enteve për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku efijencia është e vështirë për t'u matur, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike pa rritur shpenzimet.

Udhëzimet e reja të auditimit të performancës në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 3000-3100) nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve, progresi dhe praktikatat po ndërtohen nga të mësuarit mbi përvojën duke matur në çdo rast interesin publik në performancën e entit shtetëror që auditojmë.

Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me hartimin e politikave për integrimin e zonave e mbrojtura si ato kombëtare madje dhe lokale, për tu bërë pjesë e zhvillimit ekonomik, duke bërë vlerësimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, mbi performancën e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm duke promovuar eksperiencat efikase në zhvillimin e gjithanshëm të tyre. Auditimi gjithashtu do të bazohet në parimin e partneritetit të Parqeve natyrore - Qeveris – Të interesuarve për aktivitete ligjore si dhe do të ndërtohet në frymën e konstruktivitetit, të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes tyre.

Në konkluzione do të pasqyrohet mendimi më bashkëkohor nevojat për një menaxhim sa më cilësor të parqeve natyrore kombëtare, si dhe të politikave në fushën e ruajtjes së biodiversitetit në to, ku mendimet e dhëna të respektojnë interesin kombëtar e rajonal si dhe trendin e integritetit të Shqipërisë në BE.

Ruajtja e mjedisit dhe zhvillimi i tij në Shqipëri e veçanërisht në parqet natyrore kombëtare ka qenë në gjithmonë në vëmendjen e duhur, megjithatë këto vitet e fundit po synohet t'i jepet një zhvillim i mëtejshëm e kryesisht në drejtim të menaxhimit, institucionalizimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj ruajtjes dhe promovimit të tyre, për të krijuar të ardhura ekonomike nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm.

Me gjithë punën e bërë deri më sot, menaxhimi i parqeve natyrore kombëtare vazhdon të ndeshet me problematikat, që kanë të bëjnë me;

- rritjen e sipërfaqeve të parqeve natyrore kombëtare si zona të mbrojtura;
- përcaktimit të saktë të kufijve kadastral dhe të pronësisë shtetërore të parqeve natyrore kombëtare;
- përcaktimin e fushës, legjislacionit dhe përgjegjësisë shtetërore në funksion të misionit

- të krijimit të parqeve natyrore kombëtare si zona të mbrojtura;
- vlerësimin dokumentar të gjithë bimësisë dhe kafshëve brenda dhe jashtë sistemit të parqeve natyrore kombëtare si zonave të mbrojtura;
  - vlerësimin dhe ruajtjen e bimëve dhe kafshëve të rrezikuara brenda dhe jashtë sistemit të parqeve natyrore kombëtare si zonave të mbrojtura kjo edhe si një nga kërkesat për anëtarësimin në BE;
  - krijimin, funksionimin e duhur të administratave të parqeve kombëtare, mungesa e personelit të nevojshëm dhe kapacitetet e tyre;
  - kompetencat, vendimmarrjen dhe bashkëpunimin ndërmjet midis institucioneve qendrore si dhe ndërmjet institucioneve qendrore e lokale që merren me parqeve natyrore kombëtare si zona të mbrojtura;
  - mungesën e mjeteve dhe të burimeve financiare për ruajtjen dhe zhvillimin cilësor të parqeve natyrore kombëtare zbatimin e detyrave të vëna;
  - zbatimin dhe promovimin e praktikave lokale/tradicionale të përdorimit e planifikimit të territorit, dhe të zhvillimit të eko-turizmit miqësor me mjedisin;
  - marrëdhëniet e dobëta e efektive të partneritetit, shkëmbimit të praktikave më të mira që sjellin risi dhe modernizim të parqeve natyrore kombëtare si zona të mbrojtura me synimin që të integrohen si duhet në politikat kombëtare dhe lokale, për tu bërë pjesë e zhvillimit ekonomik të rajoneve dhe të vendit;
  - përcaktimin e kostove të menaxhimit të parqeve natyrore kombëtare, përcaktimin e standardeve;
  - krijimin e hapësirave lehtësuese e favorizuese biznesit për bashkëpunim dhe trajtim të parqeve natyrore kombëtare në funksion të mirë menaxhimit dhe zhvillimit ekonomik;
  - trajnimin e aftësimin profesional të punonjësve në përfitimin e përvojave të reja profesionale, duke ndarë dhe përvojën e tyre;
  - etj.

**Qëllimi i auditimit:** është përmirësimi i mirëkuptimit të aktorëve të ndryshëm, për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të menaxhimit të zonave të mbrojtura, në shpalljen, ruajtjen, përdorimin e burimeve natyrore e biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor, informimin dhe edukimin e publikut e sektorit publik e privat, për ta mbrojtur trashëgiminë natyrore.

**Objektivi i auditimit:** është pasqyrimi dhe analizimi me realizëm e objektivitet i instrumenteve që strukturat shtetërore kanë në dispozicion, për zonat e mbrojtura të cilat cilësohen trashëgimi natyrore dhe që kushtëzohen vetëm nga ligjësitë natyrore, ku veprimtaria njerëzore ushtrohet vetëm për t'i mbrojtur dhe për t'i evidentuar vlerat e tyre.

**Rëndësia e auditimit:** është të bëjë vlerësimin e performancës së sistemit të menaxhimit të zonave e mbrojtura në hartimin e politikave për integrimin e tyre, për tu bërë pjesë e zhvillimit ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm duke promovuar eksperiencat efikase.

**Mesazhi kryesor i këtij auditimi është:** “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, grupet e interesit, të krijojë një qasje të re, në hartimin e politikave mjedisore, menaxhimin me efektivitet me qëllim ruajtjen e diversitetit dhe fisibilitetit, sigurimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, që ti garantojnë dhe vlerësojnë parqet natyrore kombëtarë si gur i çmuar për zhvillimin e ekonomisë dhe mbrojtjen e natyrës të trashëguar nga brezat”.

Administrimi dhe menaxhimi i parqeve kombëtare si pjese e zonave të mbrojtura, nënkupton shpalljen, ruajtjen, përdorimin e burimeve natyrore e biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor, informimin dhe edukimin e publikut e sektorit publik e privat, për përfitime ekonomike.

Sot sfida në çështjet mjedisore qëndron në të drejtën e publikut për akses në informacionin mjedisor, akses në drejtësi për çështjet mjedisore dhe pjesëmarrja e publikut të interesuar në vendimmarrjet mjedisore.

KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance dhe dhënien e opinioneve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të menaxhimit të parqeve kombëtare si zona të mbrojtura, vlerësimin të rezultateve dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikat e ndërmarrja sepse, menaxhimi i parqeve kombëtare nuk është plotësisht në harmoni me parimet e efektivitetit, pavarësisht zhvillimeve pozitive të kohëve të fundit, përpjekjeve dhe iniciativave për ndryshime, etj., si në;

- ✓ hartimin e politikave dhe strategjive për vlerësimin e zonave të mbrojtura;
- ✓ krijimin e një qasjeje të re të pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;
- ✓ përditësimin e parqeve kombëtare dhe ri klasifikimin e tyre sipas standardeve, transformimeve natyrore dhe ndërhyrjeve jo ligjore;
- ✓ përmirësimin e infrastrukturës;
- ✓ ruajtjen nga shkatërrimi dhe degradimi i habitateve;
- ✓ ruajtjen nga erozioni tokësor dhe bregdetar;
- ✓ ruajtjen nga prerjet abuzive, peshkimi ilegal dhe përdorimi i mjeteve të ndaluara, përhapjes së zjarreve, ndërtimet dhe aktivitet pa leje,
- ✓ mirë menaxhimi i vizitorëve dhe i mbetjeve të ngurta që ata prodhojnë, brenda territorit të parqeve kombëtare;
- ✓ ruajtjes së peizazhit, të habitateve e cila në disa raste po shkon drejt zvogëlimit të tyre brenda sipërfaqeve të parqeve kombëtare;
- ✓ vendndodhjes së administratës së parqeve kombëtare larg tyre;
- ✓ numrit shumë të vogël të rojtarëve dhe vendosjen e kriterëve në përzgjedhjen tyre;
- ✓ mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit të ruajtjes së territorit me struktura të zbatimit të ligjit për efekt të sipërfaqeve shume të mëdha të parqeve natyrore kombëtare;
- ✓ buxhet të pamjaftueshëm;
- ✓ problematikave me ndarjen e re administrative në përcaktimin e administrimit të territorit të parkut natyror kombëtar dhe kalimit të pyjeve në administrimin e tyre;
- ✓ etj.

Nëpërmjet këtij auditimi ne synojmë të ndihmojmë qytetarët dhe biznesin në zhvillimin dhe edukimit e tyre në fushën e mbrojtjes së natyrës, duke analizuar problematikën aktuale dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën. Gjithashtu objektivi i këtij auditimi është pasqyrimi me realizëm dhe objektivitet i situatës, për të kontribuar në zhvillimin e një menaxhimi sa më cilësor të sistemit, identifikimin e nevojave, mbrojtjen e interesit të qytetarit, biznesit dhe palëve të tjera të lidhura me mbrojtjen e natyrës në vendin tonë në shërbim të sotmes dhe të brezave.

Me këtë auditim synojmë të sigurojmë një informacion të plotë, të drejtë dhe vlerësues mbi:

- Performancën e strukturave përgjegjëse publike të menaxhimit të parqeve kombëtare;
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe dinamikën e tij;
- Modernizimin dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e parqeve kombëtare dhe ngritjen e kapaciteteve në bashkëpunimin dhe me aktorët e tjerë;

- Rritjen e besueshmërisë së opinionit publik, biznesit e palëve të tjera të interesit për këtë shërbim publik.
- Forcimin e sistemit të financimit të zonave të mbrojtura,;
- Vlerësimin, shtimin, rivlerësimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vend;
- etj.

***Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë këtij auditimi janë;***

- ✘ Nuk është bërë një rishikim i kufijve aktualë, të parqeve natyrore kombëtarë si të azhurnimeve, saktësimit, përcaktimit dhe saktësimit të zoonimit të brendshëm, për ekosistemet dhe habitatet floristike dhe faunistike;
- ✘ nuk është ndërtuar skedari me të dhëna dixhitale i rrjetit ekologjik kombëtar për sistemin e zonave të mbrojtura të vendit;
- ✘ nuk ekzistojnë vlerësime të vazhdueshme të parqeve natyrore kombëtare në vite lidhur me gjendjen e tyre sepse;
- ✘ janë bërë përpjekje por nuk ka përfunduar studimi mbi numrin e parqeve natyrore kombëtarë në bazë të ndryshimeve që kanë ndodhur si rezultat i dëmtimeve të ndodhura në nga forcat natyrore, ndërhyrjeve jo ligjore, madhësisë së tyre sepse vihet re parqe me sipërfaqe shumë të vogël, si dhe hapjeve të parqeve të reja;
- ✘ nuk janë krijuar skedat biologjike të parqeve natyrore kombëtare.
- ✘ Mungesa e fondeve për mbarështimit, e florës dhe faunës, realizimin e planeve të menaxhimit ku të përcaktohen objektivat, normat, programet dhe planet e veprimit që nevojiten për ta arritur;
- ✘ Ka plane menaxhimi të ZM që ju ka kaluar afati i 10 viteve sepse planet e menaxhimit përgjithësisht përgatitet për të mbuluar një periudhë kohe të gjatë, 5-10 vjet;
- ✘ Jo të gjitha planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur, janë hartuar nga Ministria e Mjedisit, duke mos siguruar kështu përputhshmërinë me objektivat e këtij ligji ose të ligjeve të tjera që lidhen me të;
- ✘ Nuk është ndjekur zbatimi i planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura nga Komitetet e Menaxhimit;
- ✘ Nuk u janë miratuar nga Ministria e Mjedisit planet e menaxhimit të 3 parqeve natyrore Valbonës, Thethi dhe Shebenik Jablanicë megjithëse janë hartuar ato përsëri janë në proces rishikimi;
- ✘ Nuk janë realizuar planet e menaxhimit për 4 parqe natyrore Qaf Shtamë, Zall Gjocaj, Lurës dhe Bredhi i Drenovës, për efekt të rishikimit të tyre;
- ✘ Nuk janë saktësuar kufijtë natyrorë të habitateve për shpërndarjen e faunës;
- ✘ Nuk ka përfunduar inventarizimi dhe vlerësimi i gjendjes së treguesve të habitateve, florës dhe faunës, brenda parqeve dhe në të gjithë sistemin e zonave të mbrojtura;
- ✘ Nuk është punuar mirë këto vitet e fundit për të parandaluar ndërhyrjen e njeriut e cila ka qenë sa abuzive flagrante aq edhe e pastudiuar, çka ka sjellë rritjen e numrit të habitateve të rralla e të kërcënuara është shtuar;
- ✘ Janë marrë vetëm disa masa sporadike për eliminimin dhe rigjenerimin e pasojave nga dëmtimet natyrore në parqet natyrore kombëtare;
- ✘ Nuk ka ndjekje të mëtejshme ligjore mbi proces-verbaleve të konstatimit të dëmeve në ZM të mbajtura nga ana e AdZM-ve në qarqe nga ana e ISHMP;
- ✘ Nuk ka raport të plotë mbi gjendjen e aktivitetëve nxjerrje mineralesh (kromi), prodhime të inerteve (gurore), prodhime të pllakave të gurëve dekorativ etj.

- ✘ Ndërtimi i HEC-ve në kundërshtim me legjislacionin dhe Konventën për Ruajtjen e Jetës së Egër Evropiane dhe Habitave Natyrore (Konventa e Bernës), por edhe ligjet shqiptare për mbrojtjen e specieve të Listës së Kuqe.
- ✘ nuk ka standarde dhe kritere mbi përcaktimin e sipërfaqes parkut natyror në ha që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit në vartësi llojit të parkut natyror kombëtar, faunës dhe florës në përbërje të saj, terrenit, shtrirjes së tij, etj.;
- ✘ nuk ka përcaktim dhe pozicionim të saktë të emërimit profesional të punonjësve që kryejnë detyrën e “rojeve mjedisore”;
- ✘ kemi dy qëndrime ligjore në rregullimin e marrëdhënieve të punës kështu: marrëdhëniet e punës për punonjësit e AKZM-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” ndërsa marrëdhëniet e punës për punonjësit e AdZM-ve, rregullohen sipas Kodit të Punës.
- ✘ rezultojnë me mangësi në trajnimet dhe kualifikimet e punonjësve të AKZM dhe AdZM, për arsye se ato nuk kryhen sipas temave specifike që kanë nevojë, nga lektorë të fushës si dhe sipas kurikulave të mirë përcaktuara për punonjësit e tyre e kryesisht të “rojeve mjedisore”, “specialistëve të monitorimit dhe menaxhimit” etj.
- ✘ nuk ka standarde dhe kritere në përcaktimin e vend ndodhjes së administratave rajonale të zonave të mbrojtura që i menaxhojnë ato;
- ✘ mungesa e kompetencave të stafit të administratës së zonave të mbrojtura në mirë menaxhimi e tyre.
- ✘ Janë të pakta botimet njohëse e prezantuese të peizazheve apo për parqet kombëtare, të faunës e florës së rrallë, shoqërimet e rralla, bimët endemike, nuk njihen sa duhen monumentet e natyrës, pyjet e kullotat, etj., mungojnë si fletëpalosje, albume, guida turistike, monografi, libra të vegjël etj.
- ✘ administrata e menaxhimit të parqeve kombëtare e ZM, nuk mund të bëjë një numërim të real dhe të plotë të vizitorëve;
- ✘ mundësia e vendosjes së tarifave dhe krijimit të ardhurave nga vizitorët që vizitojnë parqet kombëtare është e vështirë dhe deri më tani nuk ka gjetur zgjidhje;
- ✘ subjektet private që ushtrojnë dhe kanë ushtruar aktivitetet në parqet natyrore kombëtare nuk derdhen të ardhura në administratat zonale apo në qendër, megjithëse janë përdoruesit dhe përfituesit më të mëdhenj të kësaj pasurie natyrore të trashëguar;
- ✘ Për parqet natyrore kombëtare nuk është kryer studim mbi analizën e rentabilitetit të menaxhimit të parqeve natyrore kombëtare;
- ✘ Për parqet natyrore kombëtare nuk janë kryer studime për vendosjen e standardeve mbi realizimin financiarisht të mirë funksionimit të sistemit të menaxhimit të parqeve natyrore kombëtare në tërësi dhe sipas llojit të tyre;
- ✘ Për parqet natyrore kombëtare nuk janë kryer studime mbi koston reale në total (vlera në para) për mirë menaxhimin e sistemit të tyre;
- ✘ Për parqet natyrore kombëtare nuk janë kryer studime dhe vendosur tregues mbi matjen e arritjes së objektivave të sistemit të menaxhimit të tyre në mbrojtje të biodiversitetit, habitaveve, popullatave të specieve të florës e faunës së egër dhe ekosistemeve natyrore si trashëgimi natyror që i përket brezave;
- ✘ Nga auditimi rezulton se nuk ka dokumentacion që Komitetet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të kenë funksionuar dhe të jenë mbledhur duke sjellë mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore nga administratat e zonave të mbrojtura dhe nga subjektet, që e ushtrojnë veprimtarinë në zonë; ruajtjen e cilësisë së zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjedisve përreth saj; zbatimin e kërkesave për përdorimin e

qëndrueshëm të burimeve natyrore të zonës. Gjithashtu ky Komitet e ka humbur aktualitetin në mënyrën e përfaqësimit të disa anëtarëve si pasojë e ndryshimeve ligjore.

### **Disa nga konkluzionet e këtij auditimi sipas gjetjeve në mënyrë të përmbledhur janë;**

- Vlerësimi, përditësimi, ri klasifikimin ku hyjnë zgjerimi i kufijve, dyfishimi i sipërfaqes, hartimi i planeve të menaxhimit, zoonimi i territoreve dhe ristrukturimi i rrjetit të zonave të mbrojtura për parqet natyrore kombëtare si trashëgimi natyrore është i rëndësishëm sepse ato:
  - ❖ Ndhimojnë në ruajtjen e diversitetit të ekosistemeve, llojeve dhe varieteteve gjenetike dhe proceseve ekologjike, të cilat janë thelbësore për mbështetjen e jetës në tokë;
  - ❖ Sigurojnë shërbime dhe të mira jetësore nga natyra dhe mbështesin mënyrën e jetesës së njerëzve duke përfshirë ujën, ajrin e pastër, klimën dhe burimet biologjike, si dhe vlerat estetike dhe shpirtërore;
  - ❖ Kanë një vlerë mjaft të rëndësishme si përfaqësuese të jetës së egër të botës, si përmbledhëse të zonave të jashtëzakonshme të pasurisë së gjallë, për ruajtjen e vlerave të rëndësishme kulturore dhe peisazhistike;
  - ❖ Shesh janë strehe për njerëz me kultura tradicionale e njohuri të pazëvendësueshme mbi natyrë;
  - ❖ Mund të jenë modele të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve që mund të aplikohen edhe në zona të tjera;
  - ❖ Kanë vlera të pafundme shkencore, edukative, kulturore, rekreative dhe shpirtërore.
- E ardhmja e vendit varet nga përdorimi i mençur i burimeve të tij natyrore, angazhimin për ruajtjen e trashëgimisë natyrore të rinovueshme dhe jo- të rinovueshme të vendit, për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të ardhshme;
- Mungesa e fondeve, planeve të menaxhimit, zbatimit të politikave kombëtare për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm në parqet kombëtare ndikon të:
  - ofrojë një kornizë për dialog dhe komunikim ndërmjet hartuesve të politikave, brenda dhe jashtë sektorit, si dhe palët e tjera përkatëse, për menaxhim të qëndrueshëm dhe zhvillim të politikave;
  - monitorojë dhe raportoj gjendjen konkrete mbi zhvillimin e sektorit në mënyrë të përhershme dhe periodike;
  - vlerësojë përparimin në menaxhimin e qëndrueshëm të ZM dhe të identifikojë çështjet e reja që dalin në planin kombëtarë;
  - formulojë e zbatojë, një kuadër monitorimi e vlerësimi edhe të politikave e programeve kombëtare dhe lokale të ZM apo planeve vjetore të veprimeve;
  - sigurojë informata mbi vlerësimin, zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;
- Mungesa e fondeve, realizimit të planeve të menaxhimit, vlerësimit të gjendjes së treguesve, mungesa e kapaciteteve njerëzore, etj., janë problemi kryesor për zbatimin planeve të veprimit për ZM, mbeten çështje komplekse që mund të zgjidhet vetëm nga qeverisja, me anë të përmirësimit të interesit dhe kapaciteteve brenda kuadrit të politikave edhe integruese si vend aspirues për në BE, e cila kërkon:
  - koordinim të përmirësuar horizontal dhe vertikal të komunikimit (p.sh. komunikimi brenda sektorit dhe komunikimi ndër-sektoriale),
  - zgjidhjen e çështjeve legjislative dhe juridiksionit të strukturave (p.sh. adresimin e plotë të strukturave që menaxhojnë, që mbrojnë, që monitorojnë dhe që do të kenë qasje në sistemin e të dhënave),
  - përfshirja e palëve të interesuara dhe qartësimi i tyre (p.sh. trajtimin për perceptime të ndryshme dhe përmirësimin e të kuptuarit në sistem të treguesve),

- unifikimin e harmonizim në mbledhjen e të dhënave, reduktimin e raportimit dhe mbingarkesave nga institucionet përgjegjëse,
- Parandalimi i dëmtimeve nga faktorët natyrore ku parësore është rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrja e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në ZM të cilat me ardhjen e stinës së verës, bëhen më evidente, ndihmon në ruajtjen e florë dhe të faunës, të cilat kryesisht duhet të përqendrohen në:
  - ngritjen e sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura;
  - hartimin e skemave dhe grafikëve të skuadrave zjarrfikëse të AdZM-ve në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor;
  - bashkëpunimi me strukturat lokale e të specializuara para fillimit të zjarreve.
- Parandalimi i dëmtimeve nga ndërhyrjet e paligjshme është faktor tjetër i domosdoshëm që ndihmon në zhvillimin dhe ruajtjen e ZM nëpërmjet:
  - I. zhvillimit të inspektimit me grup pune mbi problematikat dhe parandalimin e prerjeve të paligjshme, gjuetisë, dëmtim të biodiversitetit dhe ushtrim aktivitetesh të paligjshme nga subjekte private brenda zonave të mbrojtura të qarqeve;
  - II. zhvillimit të inspektimit mbi zbatimin e detyrave të personelit të AdZM-së.
- Rreziku vjen nga dora e njeriut dhe mungesa e ndërgjegjësimit. Mungesa e rezervateve për mbrojtjen e gjitarëve në Shqipëri, një vend i pasur në florë dhe faunë, ende pak i njohur për shumëllojshmërinë dhe veçantitë që ofron, konsiderohet si një ndër streha e vetme në Evropë të gjitarëve të mëdhenj, të zhdukur në pjesën më të madhe të Evropës, mund të çojë në zhdukjen e tyre. Zhvillimi ekonomik përgjatë viteve, mungesa e gjatë e vëmendjes, faktorët klimatikë, por edhe presioni human, konsiderohen "armiqtë" kryesorë në zhdukjen dhe minimizimin e shumëllojshmërisë në florë dhe faunë. Dikur në qytete kishte më shumë shpendë, ndërsa në zonat malore krahas dhive të egra dhe kaprojve, kishte shumë shpendë të egër si shqiponja, huta, skifteri. Sot ato janë më të paktë në numër, ndërsa rreziku për zhdukjen e tyre është evident. Shqipëria njihet si vendi i koranëve, peshk i rrallë që rritet në liqenin e Ohrit (Pogradec), por sot ky lloj peshku është drejt zhdukjes. Në vendin tonë në të 28 mijë metra katrorë të sipërfaqes gjenden afro 84 lloje gjitarësh, 320 lloje shpendësh, 37 lloje reptilësh, 15 lloje amfibësh, 313 lloje peshqish (4 prej të cilëve endemike) dhe 3850 lloje insektesh (900 prej të cilëve flutura). Gjitarë të mëdhenj të rrallë si ariu, ujku, rrëqebulli, që janë zhdukur në pjesën më të mëdha të Evropës, sot gjenden në Shqipëri. Por ambientalistët shpesh ngrenë pyetjen "Edhe sa kohë do të mund të mburremi me ekzistencën e tyre?". Është ky një paralajmërim që shtrohet në kohën e duhur për të ndërgjegjësuar gjithkënd, që nesër askush të mos përdorë shprehjen: "Na ishte një herë një vend, në malet e të cilit mund të gjeje gjitarë të rrallë, apo ku strehoheshin edhe shpendët migratorë, veçanërisht dimëronjës të ujit".
- Përcaktimi i standarde dhe kritere të sipërfaqes park natyror kombëtar në ha që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit janë të domosdoshme sepse:
  - përgjigjen për ruajtjen dhe administrimin e zonës së mbrojtur dhe për monumentet e natyrës që gjenden brenda sipërfaqes nën juridiksion të saj;
  - janë përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e zonës së mbrojtur dhe për monumentet e natyrës që gjenden brenda sipërfaqes nën juridiksion të saj;
  - zbaton politikën, strategjitë dhe programet e qeverisë në fushën e zonës së mbrojtur;

- mbikëqyr veprimtaritë në zonat e mbrojtura dhe siguron pajtueshmërinë e tyre në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore;
- ruan zonën e mbrojtur dhe kryen vlerësimin e tij;
- ndjek zbatimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur;
- vlerësimin e gjendjes ekologjike të burimeve natyrore dhe përpunon planet për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre;
- në bashkëpunim me institucionet e specializuara realizon monitorimin e zonës së mbrojtura, monitorimin e gjendjes së biodiversitetit, habitateve, popullatave dhe ekosistemeve të tyre përfshi edhe ata detare;
- mban dhe përditëson regjistrin e zonave të mbrojtura, skedarët dhe krijon bazën e të dhënave dixhitale të rrjetit ekologjik të vendit;
- propozon dhe zbaton masat dhe programet për ripërtëritjen e mjedisve të dëmtuara, të shkatërruara apo të degraduara të zonës së mbrojtur;
- identifikon dhe merr masa për mbrojtjen e biotopeve karakteristike të llojeve në përbërje të zonës së mbrojtur;
- identifikon dhe mbron zonat e populluara me llojet e florës dhe të faunës së egër si dhe rrugët e emigrimit;
- mbrojtjen e zonave të riprodhimit, të pushimit dhe të ushqimit të faunës së egër;
- ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të liqeneve ndërkufitare;
- ndjek realizimin e programeve vjetore të monitorimit të zonës së mbrojtur, në bashkëpunim me institute e katedra të specializuara, të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave;
- bashkëpunon me autoritetet shtetërore dhe lokale për mbrojtjen e interesave të banorëve lokal;
- parandalon e përdorimit të mjeteve apo metodave që çojnë në degradimin e tyre;
- përcakton vendet e vendosjes së tabelave dhe shenjave treguese;
- kontribuon në grumbullimin e tarifave për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve bio-natyrore të zonës së mbrojtur;
- kontakton përdoruesit e të gjitha llojeve;
- kontrollon përdoruesit dhe vizitorët;
- propozon vendet e peshkimit;
- zbaton infrastrukturën e domosdoshme për përdorimin e zonës së mbrojtur;
- përdor me frytshmëri fondet për mirëmbajtjen e zonës së mbrojtur;
- dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur;
- organizon sistemin e vrojtimit dhe sinjalizimit për zonën e mbrojtur;
- përgatit dhe publikon çdo fund viti raportin vjetor të gjendjes së zonës të mbrojtur dhe e paraqet në AKZM, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore;
- bashkëpunon me institucione kërkimore shkencore, me OJF-të mjedisore dhe me komunitetin për mbrojtjen e zonës së mbrojtur dhe ruajtjen e biodiversitetit të tij;
- organizon, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore, me institucionet arsimore e kulturore, me OJF-të mjedisore, me komunitetin, etj., veprimtari ndërgjegjësuese dhe bën botime të ndryshme, për të bërë të njohura vlerat e zonës së mbrojtur;
- përgjigjet dhe mirëmban qendrat e informimit e pritjes së vizitorëve dhe organizon veprimtaritë informuese, edukuese dhe vizitat ekoturistike;
- bashkërendon festimin e ditëve dhe ndodhive mjedisore që lidhen me zonën e mbrojtur, veprimtaritë informative dhe edukative.

- Përcaktimi dhe pozicionimi i saktë i emërtimit profesional të punonjësve që kryejnë detyrën e “rojeve mjedisore” është i rëndësishëm sepse ai lidhet me kontrollin e administrimin e zonës duke punuar në terren, do të lidhet me shumë funksione që duhet të kryej një punonjës i tillë si edukimi, menaxhimi, guida natyrore, turizmi, etj., prandaj përfshirja në këtë kontingjent i personave me arsimin e duhur, integritetin moral, dashurinë dhe pasionin e punës, shpirt sakrifice, është domosdoshmëri në përputhje dhe me kërkesat e kohës.
- Duke mos patur punonjës të arsimuar dhe të kualifikuar nuk plotësohet me cilësi veprimtaria shoqërisht e dobishme ruajtjes së parqeve natyrore kombëtare si trashëgimi natyrore. Arsimimi dhe kualifikimi në një fushë të caktuar i ndihmon njerëzit të specializohen në atë fushë dhe të bëhen zot të profesionit të tyre.
- Vlerësimi shumë i ulët për nga vlera monetare (paga) mbajtja e dy qëndrimeve në rregullimin e marrëdhënieve të punës bën që motivimi i punonjësve që administrojnë parqet natyrore kombëtare të mos jetë në lartësinë e duhur kur këto punonjës sipas profesioneve të tyre janë shumë të rëndësishme sepse kanë në dorë një trashëgimi natyrore për të sotmen dhe të ardhmen.
- Rishikimi i pagave të punonjësve të AdZM-ve duhet të bëhet në zbatim dhe në përputhje me misionin dhe detyrat që përmbushin sepse ato kanë përgjegjësi për:
  1. Menaxhimin e rrjetit të zonave të mbrojtura, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmë natyrore me interes të ruajtjes, sipas ligjeve kombëtare e konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare.
  2. Promovojnë, mbështetin grumbullimin e informacionit, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut për zonat e mbrojtura
  3. Mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda zonave të mbrojtura.
- Trajnimi dhe kualifikimi ndihmon punonjësit të specializohen të rriten profesionalisht në atë fushë që punojnë dhe të bëhen zot të profesionit të tyre. Trajnimi është përgatitja për një karrierë dhe punë të suksesshme është hap i domosdoshëm për çdo punonjës si dhe ndihmon punonjës të pajiset me mjetet e nevojshme për të qenë konkurrues.
- Njohja dhe ekspozimi i vlerave të natyrës të vendit tonë, në nivele të ndryshme të shoqërisë, jo vetëm që i ndërgjegjëson ata për t’i ruajtur, por edhe për t’i vënë në shërbim të saj, sidomos të ekoturizmit, nivelet dhe potencialet intelektuale nuk mungojnë.
- Kryerja e analizave të rentabilitetit bëhet për të gjykuar mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit si, njeriut, individëve, biznesit, turizmit, përfitimit të ardhurave, etj.;
- Menaxhimi i Parqeve kombëtare është i rëndësishëm që të:
  - mbrojtë trashëgiminë natyrore, duke lejuar dhe nëse është e nevojshme menaxhimin për vazhdimësinë dhe të ristaurimit të proceseve natyrore;
  - mbrojtë dhe ku është përshtatshme të restaurojë dhe zhvillojë cilësi të tjera trashëgimore dhe estetike;
  - sigurojë aksesin e publikut dhe të inkurajoj vlerësimin e publikut dhe të shijuarit e parqeve, në kushte të pajtueshme me objektivat e mësipërme;
  - zhvillojë një raport harmonik midis Parqeve kombëtare dhe komuniteteve përreth, duke marrë parasysh nevojat sociale dhe ekonomike të komuniteteve vendore.
- Mos-funksionimi i Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, ndikon negativisht në:
  - a) hartimin e planit të menaxhimit të zonës, të sigurojë përputhshmërinë e tij me strategjinë dhe planet vendore e sektoriale të zhvillimit, duke u kujdesur që këto të fundit të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e zonës;

- b) organizimin, monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit të zonës dhe të veprimtarive të licencuara, që zhvillohen në të;
- c) dhënien e mendimeve për kërkesat për përdorimin e burimeve natyrore të zonës, si dhe për pajisjen me leje mjedisore për veprimtaritë që do të ushtrohen në të;
- d) miratimin e kërkesave për lidhjen dhe zbatimin e kontratave nga administrata e zonës me subjektet private e shtetërore, vendase apo të huaja, për ushtrimin e veprimtarive në këtë zonë, kundrejt pagesave përkatëse;
- e) analizimin e kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të administratës së zonave të mbrojtura;
- f) analizimin dhe raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare dhe përcaktimin e drejtimit të investimeve në zonë;
- g) miratimin e rregulloreve të hartuara nga administrata e zonës së mbrojtur që garantojnë ruajtjen, përdorimin dhe administrimin e saj;
- h) krijimin e kushteve të përshtatshme për miratimin e studimeve të kryera, ndryshimeve në planin e menaxhimit të zonës, zgjerimin e kufijve, si dhe masa shtesë për përmirësimin e cilësive të saj;
- i) shqyrtimin e ankesave të pronarëve dhe të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në zonë, ndaj veprimeve të administratës së zonës;
- j) marrjen e masave efektive për ndalimin e zbatimit të projekteve dhe të veprimtarive, që edhe pse zhvillohen jashtë zonës, kanë ndikim negativ në të apo bien ndesh me planin e menaxhimit të saj;
- k) forcimin e veprimtarisë kontrolluese, që ushtrohen në zonë dhe përreth saj, për të zbutur dhe shmangur ndikimet negative në të;
- l) nxitjen e hartimit dhe zbatimit të projekteve për përmirësimin e cilësive të zonës;
- m) promovimin e zonave të mbrojtura edhe si zona me interes turistik.

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi:

### **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Menaxhimi i Parqeve Kombëtare”, të ushtruar në Ministrinë e Mjedisit; Agjencinë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në 12 qarqet e vendit ( Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë)

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

**Rekomandime: 1**

- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, institucione në mbrojtje të natyrës, organizata joqeveritare, donatorë, etj., të realizojë vlerësimin, përditësimin, ri klasifikimin e parqeve natyrore si trashëgimi natyrore kombëtare.
- ✓ AKZM të realizojë saktësimin, përcaktimin dhe saktësim të zoonimit të brendshëm, për ekosistemet dhe habitatet floristike e faunistike;
- ✓ AKZM të krijojë skedat biologjike të parqeve natyrore kombëtare për bërë të mundur më të lehtë vlerësimin e një parku.

**Brenda vitit 2018**

**Rekomandime: 2**

- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me AKZM të akordojë më shumë fonde për ZM dhe në veçanti për parqet natyrore kombëtare për zhvillimin e tyre si një trashëgimi e brezave për brezat.
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim AKZM, specialistë të fushës të përfundojë dhe të dërgojë për miratim planet e menaxhimit të Parqeve Kombëtare të pa përfunduara si dhe miratimin e atyre në proces.
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, specialistë të fushës institucione dhe organizata që merren me mjedisin dhe mbrojtjen e tij dhe përvojave më të mira evropiane të marrë masa për të saktësuar kufijtë natyrorë të habitateve për shpërndarjen e faunës;
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, specialistë të fushës institucione dhe organizata që merren me mjedisin dhe mbrojtjen e tij dhe përvojave më të mira evropiane të marrë masa për të kryer inventarizimin dhe përfunduar vlerësimin e gjendjes së treguesve të habitateve, florës dhe faunës, brenda parqeve dhe në të gjithë sistemin e zonave të mbrojtura.
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit të marrë masa për të parandaluar ndërhyrjen e njeriut në ZM e cila ka sjellë rritjen e numrit të habitateve të rralla e të kërcënuara është shtuar.
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit të marrë masa për eliminimin dhe rigjenerimin e pasojave nga dëmtimet natyrore në parqet natyrore kombëtare.
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim AKZM dhe ISHMP të hartojë udhëzim të përbashkët duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e këtyre institucioneve në parandalimin, ndalimin, ekzekutimin dhe vjeljen me forcë të detyrimeve ndaj shkeljeve të konstatuara, në dëm të florës dhe faunës në ZM dhe Parqeve Kombëtare, nga individë apo subjekte të ndryshëm privatë apo shtetërorë.
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim AKZM dhe ISHMP të kryejë veprimet e duhura për proces-verbalet e konstatimit të dëmeve në ZM të mbajtura nga ana e AdZM-ve në qarqe.
- ✓ Ministrinë e Mjedisit në bashkëpunim AKZM dhe ISHMP të hartojë raport të plotë mbi gjendjen e aktiviteteve nxjerrje mineralesh (kromi), prodhime të inerteve (gurore), prodhime të pllakave të gurëve dekorativ etj. Si dhe të marrë masa konkrete për mbylljen e tyre si dëmtuese të natyrës në ZM dhe të parqeve natyrore kombëtare.
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim AKZM dhe institucione të tjera shtetërore të kryejë veprimet e duhura për prishjen e ndërtimeve pa leje dhe eliminimin e derdhjes së ujërave të zeza në ZM dhe veçanërisht në parqet natyrore kombëtare
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim AKZM dhe institucione të tjera shtetërore të marrë masa për mos ndërtimin e HEC-ve në ZM dhe PNK në kundërshtim me legjislacionin dhe Konventën për Ruajtjen e Jetës së Egër Evropiane dhe Habiteteve Natyrorë (Konventa e Bernës), por edhe ligjet shqiptare.

#### **Vazhdimisht dhe brenda vitit 2017**

#### **Rekomandime: 3**

- ✓ Ministria e Mjedisit dhe AKZM në bashkëpunim me specialistë të fushës, organizata dhe institute që veprojnë në mbrojtje të natyrës të hartojnë standardet dhe kriteret në përcaktimin e sipërfaqes në ha park natyror kombëtar që duhet të mbulojë një punonjës i AdZM si roje mjedisore, punonjës i menaxhimit dhe punonjës i monitorimit në vartësi të llojit të tij.
- ✓ Ministria e Mjedisit dhe AKZM në bashkëpunim me specialistë të fushës, organizata dhe institute që veprojnë në mbrojtje të natyrës të kryejnë përcaktimin dhe pozicionimi i saktë i emërimit profesional të punonjësve që kryejnë detyrën e “rojeve mjedisore”.

- ✓ Ministria e Mjedisit dhe AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Departamentin e Administratës Publike të marrë masa për rishikimin e pagave të punonjësve të AdZM dhe klasifikimit të tyre në përputhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, marrëdhëniet e të cilit rregullojnë punonjësit e AKZM.
- ✓ Ministria e Mjedisit dhe AKZM në bashkëpunim me specialistë të fushës të hartojë programe dhe kurikula të përditësuara sipas teknikave bashkohore nga lektorë të fushës në trajnimin e “rojeve mjedisore”, “specialistëve të monitorimit dhe menaxhimit”.
- ✓ Ministria e Mjedisit dhe AKZM në bashkëpunim me specialistë të fushës, organizata dhe institute që veprojnë në mbrojtje të natyrës të hartojnë standardet dhe kriteret në përcaktimin e vend ndodhjes së administratave rajonale të zonave të mbrojtura që i menaxhojnë ato.
- ✓ Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me AKZM të marrë inisjativa ligjore në forcimin e kompetencave të stafit të administratës së zonave të mbrojtura për mirë menaxhimi e tyre.

### **Brenda vitit 2018**

#### **Rekomandime: 4**

- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, donatorë vendas e të huaj, të marrë masa për prodhimin e fletëpalosje, albume, guida turistike, monografi, libra të vegjël etj. si njohëse e prezantuese të peizazheve apo për parqet kombëtare, të faunës e florës së rrallë, bimëve endemike, monumenteve të natyrës, pyjet e kullotat, etj.
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit, Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes, të mundësojnë zgjidhjen e derdhjes së kontributeve/detyrimeve nga bizneset privatë që ushtrojnë aktivitete për qëllime fitimi, në parqet natyrore kombëtare për qëllime rehabilitimi.
- ✓ AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit institucione dhe organizata jo qeveritare që merren me mjedisin, florën, faunën si dhe grupet e interesit të marrë masa për të kryer studime mbi analizën e rentabilitetit të menaxhimit të parqeve natyrore kombëtare; për vendosjen e standardeve mbi realizimin financiarisht të mirë funksionimit të sistemit të menaxhimit të parqeve natyrore kombëtare në tërësi dhe sipas llojit të tyre; mbi koston reale në total (vlera në para) për mirë menaxhimin e sistemit të tyre; vendosjen e treguesve mbi matjen e arritjes së objektivave të sistemit të menaxhimit të tyre në mbrojtje të biodiversitetit, habitateve, popullatave të specieve të florës e faunës së egër dhe ekosistemeve natyrore si trashëgimi natyrore që i përket brezave.
- ✓ Ministria e Mjedisit, AKZM, institucionet e sistemit të menaxhimit të zonave të mbrojtura, pushteti vendor, grupet e interesit etj., të bashkëpunojnë në përmirësimin ligjor të përcaktimit të anëtareve dhe përfaqësimit të tyre në Komitetin e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura si dhe funksionimin e tij.

### **Menjëherë dhe brenda vitit 2017**

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**